



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1350/1 prot.

Tiranë, më 25. 11 . 2025

V E N D I M

Nr. 266, datë 25 . 11 . 2025

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja b), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi², mori në shqyrtim ankesën nr. 205 Regj., datë 25.09.2025, paraqitur nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit³, Aleanca kundër Diskriminimit LGBT⁴, kundër z. E. R, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore dhe aftësisë së kufizuar.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Referuar formularit të ankesës së depozituar pranë KMD-së, tek shpjegimi i fakteve për diskriminimin e pretenduar, subjektet ankues, kanë parashtruar ndër të tjera se: “...Më datë 22 Prill 2025, subjekti ndaj të cilit drejtohet ankesa, që përfaqëson një subjekt politik shqiptar, njëherësh Kryeministër i Shqipërisë, ka bërë një deklaratë⁵, si pjesë e aksioneve publike, në formën e drejtpërdrejtë të komunikimit me publikun e gjerë. Gjatë këtij prononcimi publik në takimin e mbajtur, subjekti ka cenuar personat me aftësi të kufizuar, më çrregullime të spektrit autik.

Në shpjegim të kontekstit ku ka nisur kjo vazhde daljesh dhe paraqitjesh publike, theksojmë se ka qenë një periudhë e qenësishme parapërgatitore për zgjedhjet e përgjithshme të Majit 2025 dhe si pjesë e fushatës zgjedhore që kryenin subjektet politike që ishin regjistruar si pjesëmarrës në garën zgjedhore. Ky moment ka qenë i përshtatshëm për të diskutuar publikisht ndër të tjera tema që prekin çështje të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, dhe përbën element kyç në paraqitjen e

¹ Në vijim referuar me LMD.

² Në vijim referuar me Komisioneri.

³ Në vijim referuar me KSHH.

⁴ Në vijim referuar me Aleanca LGBT.

⁵<https://ëëë.youtube.com/ëatch?v=sUj20Eqma9E>

kësaj ankese, e cila pretendon se paraqitja publike e figurave të caktuara të përfaqësuesve të subjekteve politike para dhe gjatë fushatës zgjedhore në kuadër të zgjedhjeve të përgjithshme të Majit 2025, mbart elementë të diskriminimit të drejtpërdrejtë, gjuhës së urrejtjes dhe nxitjes për të diskriminuar për shkak të karakteristikave të mbrojtura të orientimit seksual, identitetit gjinor dhe përkatësisë në një grupim të veçantë.

Pretendojmë se konteksti dhe momenti në të cilin është kryer paraqitja dhe deklarata publike objekt i kësaj ankese, bën që të meritojë një vëmendje të shtuar, pasi efekti dhe impakti i saj në shoqëri gjatë kësaj periudhe ka qenë i amplifikuar, për shkak të vëmendjes së veçantë të publikut në kuadër të periudhës para zgjedhore.

Siç reflektohet në vendimmarrjen dhe standardet e vendosura nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, standarde të cilat do të duhet të reflektohen drejtë në praktikën që shqyrtojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri (bazuar në parashikimet e neneve 5 dhe 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë), duke përfshirë këtu si një shtyllë qendrore institucionin e pavarur të KMD-së. Në Behar dhe Gutman dhe Aksu kundër Turqisë, GJEDNJ ka zhvilluar një test të rëndësishëm në lidhje me ekzistencën e elementëve të gjuhës së urrejtjes dhe asaj diskriminuese kundrejt një grupimi të caktuar të shoqërisë, i cili duhet të kryhet rast pas rasti dhe të marri në konsideratë disa faktorë: “(a) karakteristikat e grupimit të veçantë (psh. madhësia e tij, cenueshmëria e tij e veçantë ose historia e stigmatizimit dhe pozicionimi inferior i grupimit përballë shoqërisë në tërësi); (b) përmbajtjen e saktë të deklaratave negative në lidhje me grupimin në fjalë (në veçanti, shkallën në të cilën ato mund të përhapin një stereotip negativ ndaj grupimit në shoqëri, dhe përmbajtjen specifike të atij stereotipi për të vlerësuar nëse nxit intolerancë të mëtejshme ndaj grupimit në fjalë); (c) formën dhe kontekstin në të cilin janë bërë deklaratat dhe shtrirjen e tyre (që mund të varet nga vendi dhe momentumi në të cilin janë kryer), pozicioni dhe statusi i autorit të tyre, dhe shkalla në të cilën ato mund të konsiderohen se kanë prekur një aspekt thelbësor të identitetit dhe dinjitetit të grupimit në fjalë”.

Në çështjen Perinçek V. Sëitserland, GJEDNJ u shpreh se shtetet palë të KEDNJ-së duhet të marrin me seriozitet kontekstin në të cilin kryhen deklaratat që pretendohet se nxisin intolerancë, diskriminim, urrejtje apo dhunë ndaj një individi apo grupi individësh. Deklaratat duhet të analizohen për të parë nëse ato janë bërë në një sfond të tensionuar apo me peshë të caktuar sa u përket ngjarjeve me karakter politik apo social dhe se është shumë e rëndësishme të kuptohet se shpesh i njëjti fjalim/publikim/postim (në përmbajtje dhe formë) mund të ketë ndikim shumë të ndryshëm, në varësi të autorit që e kryen. Sipas Gjykatës, pikëpamjet e paraqitura nga persona publikë kanë një ndikim më të fuqishëm dhe negativ në publik, në krahasim me deklaratat e një qytetari të zakonshëm.

Në çështjen Yevstifeyev dhe të tjerë kundër Rusisë 2024, GJEDNJ konstatoi se në një tubim të mbajtur kundër gjuhës së urrejtjes, një anëtar i njohur i Asamblesë Legjislative të Shën Petersburgut i sulmoi verbalisht tre pjesëmarrës. Ai i shënjestroi ata me fyerje homofobike, për më

tepër duke i shënjestruar si “pervers”, “keqbërës”, “të prekur nga AIDS”, “pedofilë” dhe të tjerë. Retorika përfshinte edhe kërcënime fizike drejtuar të pranishmëve.

GJEDNJ konstatoi përgjegjësinë e Rusisë në shkeljen e Nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) në lidhje me Nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private) sepse nuk iu përgjigj në mënyrë adekuate gjuhës së urrejtjes homofobike dhe kërcënimeve të bëra nga një zyrtar publik gjatë një tubimi paqësor. Gjykata përsëriti se gjuha e urrejtjes që u drejtohet individëve bazuar në orientimin seksual mund të bie nën Nenin 8, pasi ndikon në identitetin dhe dinjitetin e tyre - edhe kur bëhet publikisht. Autoritetet ruse kishin një detyrim pozitiv për të hetuar dhe për t’iu përgjigjur në mënyrë efektive abuzimit dhe kërcënimeve homofobike nga personat përgjegjës. Mosveprimi i tyre në këtë drejtim dërgoi një sinjal tolerance ose mbështetjeje për një sjellje të tillë, e cila është e papajtueshme me vlerat e Konventës.

Duke ju referuar këtyre standardeve dhe testit mbi ekzistencën e elementeve të gjuhës së urrejtjes në jurisprudencën e GJEDNJ-së, pretendojmë se paraqitja publike e subjektit të kësaj ankese, si person i njohur gjerësisht në publik, gjatë periudhës së referuar në këtë ankesë, e cila përfaqëson një moment me rëndësi specifike politike, siç është periudha parazgjedhore dhe fushata zgjedhore e subjekteve politike, në lidhje me deklaratën që ka marrë përsipër të kryej kundrejt çështjeve dhe grupimit LGBTI+, një grupim tradicionalisht i diskriminuar në të drejta dhe dinjitet në shoqërinë Shqiptare, duhet të jetë objekt i një analize të kujdesshme nga KMD.

Më datë 22 prill 2025 gjatë një daljeje publike, takimi publik, z. E. R ka deklaruar: “Se për mua, kush shkon në kënetë është gjysmak. Domethënë të zgjedhësh midis BE-së dhe kënetës, nuk je mirë. Politikisht je autik, nuk je mirë. Populli është i sëmurë.”

Përmes kësaj ankese, Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe Aleanca LGBTI, si persona juridikë me interes legjitim, pasi kanë në misionin dhe statutin e tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, pretendojnë se paraqitja mediatike e subjektit të mësipërm, përmban elementë që arrijnë të prekin nivelin e garancive dhe mbrojtjes së ofruar nga kuadri ligjor për mbrojtjen nga diskriminimi, përkatësisht duke arritur nivelin e diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe duke nxitur urrejtje për shkak të aftësisë së kufizuar dhe gjendjes shëndetësore, mes përhapjes me qëllim dhe vetëdije të plotë të deklaratave publike mes mediumeve të ndryshme, të cilat në tërësinë e tyre krijojnë dhe mbartin mundësinë të krijojnë në të ardhmen në shoqëri një perceptim denigrues, fytes, diskriminues dhe në përgjithësi negativ.

Në përmbushje të misionit dhe veprimtarisë së Komitetit Shqiptar të Helsinkit për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut duke bashkëpunuar edhe me aktorë të tjerë të shoqërisë civile, organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, në bashkëpunim me Aleancën LGBTI vlerësojmë se paraqitja e kësaj ankese është një mjet për të arritur në realizimin efektiv dhe real të këtyre të drejtave.

Z. E. R, Kryeministri i Shqipërisë, njëkohësisht edhe kryetar i Partisë Socialiste të Shqipërisë, në një takim të mbajtur me mbështetës të krahut të tij politik, me datë 22 prill 2025⁶, ka bërë deklaratë duke u shprehur se personat që nuk zgjedhin atë janë autik politikisht, të sëmurë.

Deklarata e subjektit në fjalë në përmbajtjen e saj dhe në tërësi krijon një perceptim negativ dhe thellon stigmën ndaj çdo personi me aftësi të kufizuara (me çrregullime të spektrit autik). Në tërësi deklarata publike është ndjekur mes platformave sociale, pa llogaritur numrin e shikimeve që ka marrë në televizion në momentin që është shfaqur për publikun, numrin e personave që e ka dëgjuar direkt në hapësira publike, apo pas shpërndarjeve në rrjetet sociale, çka e bën atë të një rëndësie specifike.

Përfaqësuesit politikë, përfshirë deputetët, drejtuesit e partive, personat që punojnë në strukturat e partive politike dhe kandidatët në zgjedhje, gëzojnë një rol të thellë ndikues në formësimin e diskursit publik dhe të opinionit shoqëror. Për këtë arsye, ata mbartin një detyrim të shtuar për të mos përhapur gjuhë urrejtjeje, diskriminuese dhe përjashtuese, sidomos ndaj grupeve vulnerabël shoqërore. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka theksuar në mënyrë të përsëritur se aktorët politikë nuk janë “qytetarë të zakonshëm” në diskursin publik dhe se fjalët e tyre, veçanërisht gjatë periudhave para, gjatë dhe pas elektorale, kanë një peshë dhe ndikim të shumëfishtë. Në çështjen Feret kundër Belgjikës (nr. 15615/07, 2009), Gjykata mbajti qëndrimin se gjuha politike që përçan dhe nxit urrejtje justifikon ndërhyrje legjitime dhe të nevojshme nga shteti. Po ashtu, në çështjen Zemmour kundër Francës (nr. 63539/19, 2022), GJEDNJ ripohoi se retorika përjashtuese dhe përçarëse e përdorur nga figura publike që synon të përjashtojë grupe të caktuara nga identiteti kombëtar klasifikohet jashtë mbrojtjes së nenit 10 të Konventës.

Këto standarde janë tërësisht në përputhje me analizën e ofruar nga Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR) në dokumentin “Hate Speech and Incitement to Hatred in the Electoral Context” (2023), i cili ngre shqetësimin për përhapjen e gjuhës së urrejtjes në periudha zgjedhore dhe thekson rolin thelbësor të liderëve politikë për të parandaluar përshkallëzimin e saj. Dokumenti nënvizon se gjuha e urrejtjes e përdorur nga figura politike ka potencialin për të stigmatizuar grupet e marginalizuara, për të minuar integritetin zgjedhor dhe për të nxitur përjashtim social. Liderët politikë dhe publikë kanë detyrimin jo vetëm të mos përçojnë gjuhë diskriminuese, por të reagojnë publikisht dhe me vendosmëri kundër saj, duke kontribuar në mbrojtjen e demokracisë dhe të barazisë.

Për më tepër, në përputhje me nenin 20 (2) të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICPR), çdo formë nxitjeje për urrejtje që përbën rrezik të menjëhershëm për diskriminim, armiqësi apo dhunë duhet të ndalohet me ligj, ndërkohë që Plani i Veprimit i Rabatit i OKB-së ofron një test me gjashtë kritere për të identifikuar rastet e gjuhës së urrejtjes që kërkojnë përgjigje të

⁶ <https://shqiptarja.com/lajm/tha-ne-takim-se-te-votosh-keneten-je-politikisht-autik-r-kerkoj-ndjese-term-i-gabuar-dyfshojme-mbeshtetjen-per-femijet-me-aftesi-te-vecanta>.

drejtpërdrejtë shtetërore: (1) konteksti, (2) autori, (3) synimi, (4) përmbajtja dhe forma, (5) shkalla e përhapjes, dhe (6) gjasat për dëmtim real dhe të menjëhershëm.

Në këtë kuadër, është e domosdoshme që deklaratat publike të përfaqësuesve politikë të vlerësohen jo vetëm si ushtrim i lirisë së shprehjes, por edhe në dritën e ndikimit të tyre të drejtpërdrejtë në krijimin e një klime sociale të mbushur me intolerancë dhe stigmatizim, veçanërisht ndaj personave LGBTI+, të cilët shpesh janë në qendër të fushatave polarizuese dhe diskursit përjashtues. Këto deklaratat, nëse mbartin elemente të urrejtjes, kanë kapacitetin të dëmtojnë jo vetëm individët në mënyrë të drejtpërdrejtë, por edhe vete strukturën demokratike të përfaqësimit dhe barazisë në shoqëri.

Mbi raportin e kufizimit të gjuhës së urrejtjes dhe asaj diskriminuese dhe lirisë së shprehjes:

Në bazë të nenit 10 të KEDNJ-së, e aplikueshme brenda territorit dhe juridiksionit shqiptar, referuar shkurtimisht jurisprudencës së GJEDNJ-së në çështjet Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Ebakan kundër Turqisë, vlerat e demokracisë si toleranca dhe respekti ndaj dinjitetit të barabartë të çdo qenieje njerëzore kërkojnë kufizimin e lirisë së shprehjes sa herë është e nevojshme në një shoqëri demokratike, e sidomos për të ndaluar apo parandaluar të gjitha format e shprehjes që shpërndajnë, nxisin, promovojnë apo justifikojnë urrejtje bazuar në mungesën e tolerancës dhe që shkaktojnë ofendime apo shqetësim ndaj grupimeve të caktuara të shoqërisë. Në çështjen Vejdeland dhe të tjerë kundër Suedisë, në një arsyetim të kujdesshëm, i cili konsideroi me hollësi përmbajtjen e thirrjeve të disa përfaqësuesve fetarë ndaj komunitetit LGBTI+, GJEDNJ vendosi se natyra e këtyre thënieve nuk mund të konsiderohej brenda nivelit të lirisë së shprehjes dhe se shtetet anëtare të KEDNJ-së duhet të tregoheshin të kujdesshme në kufizimin e arsyeshëm të lirisë së shprehjes për të parandaluar deklaratat “fryese të pajustificuara” dhe diskriminimin kundrejt një grupi të caktuar, mes një testi që paraqet një prag edhe më të ulët se “gjuha e urrejtjes”.

Në një serë vendimmarrjesh të tjera, duke përfshirë Perinçek; Le Pen v. France; Kasymakhunov dhe Saybatalov v. Russia; Vejdeland dhe të tjerë v. Suedisë; Beizaras dhe Levickas v. Lithuania dhe Feret v. Belgium, GJEDNJ ka zgjeruar konceptin e gjuhës së urrejtjes duke përfshirë në të nxitjen e diskriminimit, të cilën e konsideron një “formë të nxitjes së intolerancës në shoqëri, e cila, së bashku me nxitjen e urrejtjes ndaj një apo disa individëve, përbën një nga kufijtë që nuk duhet të kapërcehen kurrë në ushtrimin e lirisë së shprehjes nga asnjë individ apo subjekt”. Me referencë në vendimmarrjet e këtyre çështjeve, GJEDNJ shprehet se kufizimi i nevojshëm i lirisë së shprehjes në një shoqëri demokratike shtrihet edhe mbi deklaratat negative të bëra publikisht ndaj një grupimi (etnik, fetar ose tjetër) që mbartin konotacion fyes, tallës, shpifës dhe portretizojnë në një mënyrë negative të gjithë këtë grupim popullsie.

Portretizimi negativ, denigrues, diskriminues dhe fyes ndaj personave me AK, mes deklaratave, daljeve mediatike dhe postimeve publike nga subjekti ndaj të cilit drejtohet kjo ankesë, në tërësi

mbart potencialin të nxisi intolerancë, stigmatizim, diskriminim dhe urrejtje ndaj çdo personi me AK, në vend.

Pretendimet përfundimtare:

Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe Aleanca LGBTI, depoziton këtë ankesë në funksion të inkurajimit të përmbushjes së qëllimit të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përkatësisht përcaktuar në nenin 2/c të tij, si një instrument për të ofruar mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për çdo qytetar në vendin tonë, pavarësisht karakteristikave të mbrojtura që mbart.

Pretendojmë se, Kryeministri i Shqipërisë, njëherësh dhe Kryetar i Partisë Socialiste të Shqipërisë, në një takim të mbajtur me mbështetës të krahut të tij politik, me datë 22 prill 2025⁷, ka bërë deklaratë duke u shprehur se personat që nuk zgjedhin atë, janë autik politikisht, të sëmurë.

Nga ana tjetër, po t’i referohemi kontekstit të plotë të deklaratës⁸, diskriminimi i drejtpërdrejtë rezulton si pasojë e referimit ose krahasimit të personave autik me një grup të caktuar politik. Çrregullimi nga i cili vuajnë personat autik është një gjendje shëndetësore e cila vështirëson në mënyrë të ndjeshme jetën e vetë personit dhe të tjerëve që kujdesen për të, duke e bërë të rëndë përballimin e një gjendjeje të tillë.

Përdorimi i termave të tillë si: “i metë”, “i mangët”, duke iu referuar drejtpërdrejtë autizmit si gjendje shëndetësore, diskriminon në mënyrë drejtpërdrejtë këta persona, duke i vënë para një situatë të pafavorshme në krahasim me të tjerët, pa pasur një justifikim ose arsye legjitime.

Në këtë mënyrë, dinjiteti dhe e drejta e tyre për t’u trajtuar në mënyrë të barabartë në të drejta, pavarësisht gjendjes së tyre shëndetësore është cenuar rëndë dhe në mënyrë të pajustifikueshme.

Autizmi si gjendje shëndetësore në këtë rast është përdorur nga ana e subjektit të denoncuar, si fyerje, përjetëson stereotipet e aftësive të kufizuara duke nënkuptuar se autizmi është i barabartë me mangësi ose diçka “të gabuar”. Një deklaratë e tillë është thellësisht mungesë respekti ndaj individëve me spektrin e autizmit dhe familjeve të tyre.

Sakaq, subjektet ankues kërkojnë nga Komisioneri, shqyrtimin e kujdesshëm të kësaj ankese dhe marrjen e një vendimi të drejtë që tregojë kujdes të veçantë në konsiderimin e raportit të hollë mes lirisë së shprehjes dhe gjuhës së urrejtjes, si dhe konstatimin e elementeve të ndryshme

⁷ <https://shqiptarja.com/lajm/tha-ne-takim-se-te-votosh-keneten-je-politikisht-autik-r-kerkoj-ndjese-term-i-gabuar-dyfishojme-mbeshtetjen-per-femijet-me-aftesi-te-vecanta>

⁸ “Se për mua, kush shkon në kënetë është gjysmak. Domethënë të zgjedhësh midis BE dhe kënetës nuk je mire. Politikisht je autik, nuk je mire. Populli është i sëmurë.”

diskriminuere në lidhje me momentet e parashtruara më sipër, në funksion të shmangies dhe parandalimit të praktikave të rrezikshme për demokracinë dhe të drejtat e njeriut në Shqipëri.

I. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Neni 7 i LMD-së, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, shkronja “b”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat e paraqitura nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm, për çështje që lidhen me interesa kolektive.

Bazuar në dispozitën e mësipërme ligjore rezulton se, kërkesën për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit mund ta bëjë edhe një palë e cila nuk pretendon diskriminim në emrin e vet, pra që nuk ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë të vetin. Në këtë rast që kjo palë të legjitimohet për të bërë ankesë dhe për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit, duhet të provojë se është mbajtëse e interesave kolektive, të cilat mund të cenohen nga procedura konkrete administrative. Një palë e tillë duhet të provojë lidhjen e detyrueshme, të drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ajo kryen dhe çështjes së paraqitur pranë Komisionerit.

Bazuar në nenin 3, pika 11, të LMD, përcaktohet se: *“Organizatat me interesa legjitime” janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit”*.

Së pari, nga aktet e administruara rezulton se palët ankuese, Shoqata “Komiteti Shqiptar i Helsinkit” është një organizatë jofitimprurëse, regjistruar si person juridik, me urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr. 17/1, datë 12.01.1991 dhe Qendra “Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT”, është një organizatë jofitimprurëse, regjistruar si person juridik me vendimin nr. 567, datë 10.11.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në ankesën e paraqitur palët e mësipërme ankuese, ato nuk pretendojnë se janë cenuar në interesin e tyre të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë, por pretendojnë se gjuha e përdorur dhe e shpërndarë nga ana e subjektit kundër të cilit kanë paraqitur ankesën, diskriminon personat me AK, me çrregullime të spektrit autik dhe përbën gjuhë urrejtje për shkak të gjendjes shëndetësore dhe aftësisë së kufizuar.

Palët ankuese Komiteti Shqiptar i Helsinkit është organizatë jofitimprurëse, e cila ka në misionin e saj mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut për çdo person në Shqipëri, ndërsa Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT, është organizatë jofitimprurëse e krijuar me qëllimin për të promovuar dhe për të mbrojtur të drejtat e komunitetit LGBT dhe të grupeve të tjera vulnerabel, përfshirë ato me AK, në Shqipëri.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së palëve ankuese dhe çështjes që këto organizata kanë paraqitur, duke vlerësuar përfundimisht se ankuesit legjitimohen para Komisionerit për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Së dyti, Komisioneri thekson se, fillimisht palët ankuese kanë depozituar një ankesë të vetme duke pretenduar përdorimin e gjuhës së urrejtjes nga disa subjekte.

Referuar parashtimeve të paraqitura në ankesë, rezultoi se deklaratat e pretenduara si gjuhë urrejtje nga ana e të gjithë subjekteve të mësipërme ishin bërë në momente të ndryshme kohore dhe gjithashtu, shkaqet e pretenduara si diskriminuese, përveç shkaqeve të identitetit gjinor dhe orientimit seksual, konsistojnë në gjendjen shëndetësore, aftësinë e kufizuar dhe përkatësinë në një grup të veçantë.

Në këto kushte, Komisioneri vijoi shqyrtimin e pretendimeve të paraqitura nga palët ankuese të ndara sipas subjektit i cili pretendohet se ka përdorur gjuhë urrejtje.

Së treti, Komisioneri kreu verifikimet në lidhje me materialin e pretenduar nga palët ankuese objekt i ankesës. Në cilësinë e provës lidhur me deklaratën e pretenduar diskriminuese, palët ankuese kanë vendosur në dispozicion *Link-un*: <https://www.youtube.com/watch?v=sUj20Eqma9E>
Vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes nga Komisioneri.

Shqyrtimi i Komisionerit do të bazohet në përmbajtjen e videos së administruar dhe deklaratës që palët ankuese kanë parashtruar në ankesë, që pretendohet se është bërë nga ana e subjektit z. E. .

Nga verifikimi i link-ut, Komisioneri administroi fjalimin ku pasqyrohet përmbajtja e deklaratës së bërë nga subjekti z. E. R, që pretendohet se përbën gjuhë urrejtje.

Gjatë takimit publik të mbajtur me datë 22 prill 2025, z. R deklaroi ndër të tjera, se: “...se për mua, kush shkon në kënetë është gjysmak. Domethënë të zgjedhësh midis BE dhe kënetës nuk je mirë. Politikisht je autik, nuk je mirë. Populli është i sëmurë.”

Referuar parashtrimeve të bërë në ankesë nga ana e palëve ankuese, përmbajtja e deklaratës sipërcituar, është pretenduar si gjuhë urrejtje.

Për sa më lart, për të vijuar me verifikimin e fakteve të pretenduara nga subjektet ankues, lidhur me diskriminimin e personave me AK, përmes gjuhës të përdorur nga z. R, Komisioneri, pas këqyrjes dhe një kërkimi të thjeshtë në you tube dhe mediat e shkruara, verifikoi se, z. R ka kërkuar ndjesë publike për deklaratën e mësipërme.

Përmes një video në rrjetet sociale, po në datë 22 prill 2025⁹, ai pranoi se deklarata ka qenë e papërshtatshme edhe pse e bërë pa qëllim, duke u shprehur si më poshtë vijon:

"Nuk mund të mos e ndaja dot këtë reflektim. Të gabosh është njerëzore, ndërsa të mos kërkosh ndjesë nuk është burrërore. Krejt pa dashje sot kam cenuar fëmijët autikë dhe me siguri kam lënduar prindërit e tyre duke folur për autizëm politik, shprehje që më ka mbetur diku në mendje se është përdorur edhe në literaturën politike, akademike dhe më doli sot krejt padashje. Por, ja u desh të gaboja dhe pastaj të mësoja, se vitesh konsiderohet e papërshtatshme dhe në fakt me plot të drejtë.

Prandaj kërkoj ndjesë dhe u grantoj se kam jo vetëm respekt, por edhe admirim për ta dhe për prindërit e fëmijëve me aftësi të veçanta që më ka shtyrë që të nxis dyfishimin e mbështetjes së tyre nga qeveria. Që e kam thënë në më shumë se një rast do jetë pjesë e projektbuxhetit të 2026, ndërsa lehaqenieve që u kapën pas fëmijëve autik si i mbytur pas fijos së barit për të përfituar pikë në sy të atyre prindërve të nderuar, u jap fjalën se kjo do të jetë një motiv më shumë që ta shpenzoj çdo energji timen që t'i japim mësimin e merituar më 11 maj për të gjitha prapësit e tyre të pamërituara në kurriz të këtij populli dhe këtij vendi."

Rezultoi se vërtet z. R në një moment, gjatë takimit të datës 22 prill 2025, e ka përdorur një krahasim dhe term të tillë, (në referim të personave me AK/çrregullime të spektrit autik), por në të njëjtën ditë, ka kërkuar falje për krahasimin e bërë prej tij dhe gjuhën e përdorur, duke lënë të nënkuptohet se ishte një lapsus dhe gabim i bërë pa dashje.

⁹ <https://shqiptarja.com/lajm/tha-ne-takim-se-te-votosh-keneten-je-politikisht-autik-r-kerkoj-ndjese-term-i-gabuar-dyfishojme-mbeshtetjen-per-femijet-me-aftesi-te-vecanta>

Komisioneri është i mendimit se, jemi në kushtet kur subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa ka kërkuar falje publikisht dhe në mënyrë të menjëherëshme për krahasimin e gjuhën e përdorur prej tij.

Theksojmë se, Komisioneri ka patur dhe ka vazhdimisht në vëmendjen e vet, faktin që përdorimi i mjeteve audiovizuale apo medias së shkruar për të bërë publike qëndrime verbale, opinione apo veprime konkrete të personave të caktuar publikë apo subjekteve të ndryshme politike, të jetë i kujdesshëm dhe të mos ndikojë negativisht në përcjelljen e këtyre qëndrimeve që të mos kuptohen si deklarata fyese ndaj këtij komuniteti.

Mirëpo, sjellja e subjektit ndaj të cilit është bërë ankesa nuk reflekton dukshëm një qëndrim të qëllimitë diskriminues kundrejt personave me AK/çrregullime të spektrit autik, në mënyrë që të cenonte parimin e mosdiskriminimit, në zbatim të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Sjelljet diskriminuese përmes nxitjes së urrejtjes jo gjithmonë shfaqen përmes thirrjeve për kryerjen e akteve të dhunës apo ndonjë akti tjetër të paligjshëm. Sulmet ndaj grupeve të veçanta të popullsisë të kryera përmes fyerjes, talljes apo shpifjes, mund të jenë të mjaftueshme për autoritetet për të përligjur trajtim të menjëhershëm dhe efikas kundër shprehjeve raciste, përballë lirisë së shprehjes të ushtruar në mënyrë të papërgjegjshme.

Mirëpo, për sa më lart, Komisioneri, vlerëson se nuk jemi në rrethanat kur subjekti ndaj të cilit është paraqitur ankesa ka konsumuar një sjellje diskriminuese përmes gjuhës së urrejtjes, apo të ketë dashur të nxitë urrejtje përmes përdorimit të kësaj gjuhe. Ai ka kërkuar falje publike menjëherë pas citimit të fjalës “autik politik” si krahasim të përdorur prej tij dhe gjuhës së përdorur referuar personave me çrregullime të spektrit autik.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja ç), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse është *haptazi e pabazuar*.....”, ankesa e subjeteve ankues, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj¹⁰.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/b, si dhe nenin 33, pika 4/ç, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

¹⁰ Për analogji citojmë Vendimin nr. 65, datë 07.08.2017, të KMD-së.

1. Mospranimin e ankesës Nr. 205, datë 25.09.2025, të paraqitur nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe Aleanca kundër Diskriminimit LGBT, pasi nuk plotësohen kriteret ligjore të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA